



Republika e Kosovës * Republic of Kosovo
Komuna * Municipality
Hani i Elezit



DATE: 28.02.2022

NR.09/ 1495 /2022

KONTRATË PËR SHITJE TË ASETEVE

Numri i kontratës¹: 659-22-468-1-6-10 / KKHE-22-001

KOMUNA HANI I ELEZIT, (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues-Shitësi i aseteve"), në njërën anë; dhe
VB INVEST SH.P.K., Rr. Hajrullah Abdullahi -Prishtinë, (në vazhdim "Blerësi"), me NUI.811310200 në anën tjetër, janë pajtuar të lidhin një kontratë publike për shitje të aseteve shënuara me poshtë:

Shitja e Aseteve (Rezervuarët e përdorur 3 cope dhe autoambulanca 1 Copë) me numër identifikues: 659-22-468-1-610 Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë shitja e aseteve si në vijim:

Nr.	Grupi
1	Shitja e Aseteve (Rezervuarët e përdorur 3 copë dhe autoambulanca 1 Copë)

Neni 2 Kushtet e dërgesës

2.1 Afati kohor për dorëzim do të jetë ditë nga koha e lëshimit të urdhër blerjes nga ana e Autoritetit Kontraktues.

2.2 Vendi i dorëzimit të shitjes do të jetë Komuna Hani i Elezit, në vendin ku gjenden asetet e shitura.

2.3 Inkotermi² i zbatueshëm do të jetë .

Neni 3 Origjina

3.1 Furnizuesi duhet të dorëzojë një certifikatë të origjinës së furnizimeve, më së voni atëherë kur e kërkon pranimin e përkohshëm të furnizimeve. Mosveprimi sipas këtij kushti mund të ketë si rezultat ndërprerjen e kontratës.

3.2 Origjina e mallrave do të përcaktohet sipas Kodit të Doganave të Bashkësisë Evropiane (Community Customs Code-) ose sipas marrëveshjeve ndërkombëtare të cilat i ka nënshkruar vendi në fjalë.

Neni 4 Çmimi

4.1 Çmimi total i shitjes duhet të jetë, **Llot-I- 7,500.00** (Rezervuarët e përdorur 3 copë) €; [shtatë mijë e pesëqindë euro e zero centi] Euro. **Llot-II- 1,300.00** (Autoambulanca 1 copë) - Një mijë e treqind euro

4.2 Çmimi i përmendur në Nenin 4.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që bletësi i theksuar me lartë i ka borgj Autoriteti Kontraktues (Komuna Hani i Elezit) sipas kesaj kontratës.

4.3 Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve.

[Nëse disa artikuj iu nënshtrohen ndryshimeve]

Çmimet e artikujve që janë subjekt të rregullimit të çmimit janë subjekt i rregullimeve në vijim: [shëno indeksin ose burim tjetër të rregullimit të çmimeve]

4.4 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 5 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

¹ Ju lutemi referojuni këtij numri të kontratës në dokumentet e faturimit dhe pagesës, procedurat dhe transaksionet që lidhen me thesarin.

² Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

5.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kjo marrëveshje e kontratës;
- (b) Kushtet e Veçanta të Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
- (d) Tenderi i Furnizuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
- (e) Oferta financiare;

5.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 6 Komunikimet

6.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Furnizuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

6.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

6.3 Kudo që në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetojë", "miratoj" ose "vendosë" do të shenohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

6.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën ³ në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Furnizuesin.

Për Autoritetin Kontraktues-Shitesi i aseteve

Emri:	Xhevdet BUSHI
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	28.02.2022
Vula:	

Për Blerësin e aseteve

Emri:	Berat HASOLLI
Pozita:	Drejtor
Nënshkrimi:	
Data:	28.02.2022
Vula:	

³ Gjuha do të jetë gjuha e shfrytëzuar nga tenderuesit në këtë tender.

KUSHTET E VEÇANTA

Numri i kontratës: 659-21-9704-1-3-6/C236

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	1.2	Gjuha e përdorur do të jetë Shqipe.
Siguria e ekzekutimit	2	N/A
Sigurimi	2.1	N/A
Programi i ekzekutimit	3.	<i>[Kohëzgjatja e kontrates eshte me afat prej 30 ditë nga koha e nenshkrimit te saj</i>
Cilësia e Aseteve	6.	<i>Asetete jane te perdorura dhe shiten ashtu ku jane si janë dhe AK-nuk mban pergjegjesin per me tej pas dorezimit te tyre</i>
Inspektimi dhe testimi i asetëve	7.	<i>Asetet shiten ne at gjendje si jane dhe ka qene koha kur OE-apo personat fizik kan pasur afatin e tyre per ti pare asetet qe po shiten.</i>
Pagesa e asetëve që shiten	8.	<i>Pagesa do te behet brenda afati te kohëzgjatje se kontrates,dhe mjetet do te dalin ne llogari te AK-se Komuna Hani i Elezit</i>
Dorëzimi i asetëve	9.	<i>Dorezimi do te behet pas pas realizimit te pageses nga blersi i asetëve i deshmuar me konfirmim te realizimit te pageses ne bankë</i> <i>Terheqja e asetëve nga vendi ku gjenden duhet te behet sa me shpejt nga ana e blersit,pas realizimit te pageses dhe dorezimit te deshmis se pageses ne AK- Komuna Hani i Elezit</i>
Obligimet e garancionit	10	N/A
	10.1	Shitja e asetëve behet sipas parimit ku jane si jane dhe AK-nuk mban pergjegjesi tej pas dorezimit te tyre blersit.
Shërbimet pas shitjes	11.	AK-nuk mban pergjegjesi per me tej pas dorezimit te asetëve blersit
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	12.	Zyra e Prokurimit – Komuna e Hanit te Elezit ose Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik – Divizioni i rregullave
Zgjidhja e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	13.	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet <i>[Gjykata Themelore Prishtinë-Departamenti per çeshtje ekonomike]</i> në pajtim me ligjin në Kosovë. ose b) kurdo qe palët pajtohen, çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në arbitrazh të <i>[specifiko organin për zgjedhjen e mosmarrëveshjes]</i> në pajtim me <i>[specifiko rregullat e arbitrazhit (rregullat e Dhomës Ndërkombëtare të Tregtisë, Komisioni i Kombeve të Bashkuara mbi Ligjin e Tregtisë Ndërkombëtare, apo procedura të tjera të arbitrazhit të njohura ndërkombëtarisht)].</i>